



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr. 1438 /2019  
Data: 20.02.2019

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e parë - I- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.01.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergencë) Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit) Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore) Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit), Përfaqësuesit e Organizatave të Veteranëve të Luftës së Ushtris Çlirimtare të Kosovës, Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se mungon një anëtarë i kuvendit të komunës (z.Sabrije Krasniçi).

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i propozim vendimi për ndarje e mjeteve financiare për bursa për studentë në komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2018/2019.
3. Miratimi i planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2019.
4. Miratimi i planit të punës së tri komitetave konsultative për vitin 2019.
5. Miratimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2019.
6. Miratimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2019.
7. Informatë mbi veprimtarit afariste.
8. Miratimi i kërkesës për përcaktimin, emërtimin e sheshit dhe ngritjen e një shtatore për dëshmorin Gafurr Loku.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin 14 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- faqe nëntë të hiqet diskutimi që është shënuar : Në seancë të kuvendit që parashtrova pyetje u shqetësova kur u potencua se duhet të bëhet kërkesë për një vizitë të tillë sepse po të konkullojë sot me dhënë mësim nuk më kishin pranuar se nuk më duan për arsyen se në momentin që do të hyjë në oborrin e shkollës e vërejë se sa punohet. Sepse nuk kam potencuar siç është shënuar dhe unë e kam tërhequr kërkesën.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 14 anëtarë të kuvendit të komunës).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## **2. Miratimi i propozim vendimi për ndarje e mjeteve financiare për bursa për studentë në komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2018/2019.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi thekson:-** materialin e keni pranuar me kohë dhe është një gabim teknik sepse duhet të jetë tridhjetë e jo njëzet. Në këtë vit në krahasim me vitin e kaluar e kemi shtuar numrin e bursave nga njëzet në shtuar ndonjë propozim mund të jepni propozimet e juaja.

**Akif Shkreta thekson:-** te fakulteti i arteve duhet të ndryshohet dhe të jetë akademia e arteve si lëmi e përgjithshme e jo vetëm një drejtim që është aktrimi. I rekomandojmë drejtorit të drejtorisë për arsim që të vazhdohet praktika për studentët të cilët nuk marrin bursa të ftohen në takim dhe tu prezantohen kriteret se si kanë qenë, në mënyrë që të jetë transparente qasja e ndarjes së bursave.

**Nora Xhoni thekson:-** e përshëndesë këtë propozim vendim për arsyen që është rritë numri për ndarje të bursave nga njëzetë është bërë në tridhjetë që do të jetë një sukses për neve dhe për studentët të cilët do të janë përfitues të bursave

**Mefail Suma thekson:-** te neni tre keni shënuar se në rast të mos plotësimit të bursave sipas kuadrit deficitare, plotësohet sipas rregullores për ndarjen e bursave. Duhet të analizohet mirë kjo dhe të hiqet. Te fakultete është paraparë aktrimi por çka është bërë me aktrrim deri më tanë. Kemi persona të cilët kanë diplomuar në fakultetin e biologjisë dhe janë në shtëpi, keni propozuar që me ju ndarë bursë studentëve të cilët janë në drejtimin e inxhinierisë por ku planifikoni me i punësuar. Komuna duhet të planifikon që për çdo vit të punëson praktikant në komunë për shkak se çdo konkurs që del kërkohen dy vite përvjohje pune.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** pajtohemë me këtë propozim për ndarjen e bursave me që nuk është numër i mjaftueshmë për studentët por nuk e lejojnë mundësitë buxhetore më shumë sepse ne kemi kërkuar të jetë numri 40 por mundësit janë që të ndahen bursa për 30 studentë por me gjithë atë pajtohemë. Në KPF u kërkua që të jetë akademia e arteve dhe është mirë që këtë ndryshim me pas parasysh. Është mirë të kemi kujdes kur i stimulojmë me bursa studentët sepse janë drejtimet deficitare dhe duhet të ju bëhet një zgjidhje sepse mos të stimulohen dhe të mbeten rrugëve.

**Nuriman Kuka thekson:-** çdo herë që pranojmë materiale prej drejtorisë për arsim dhe kulturë për sport nuk potencon që e kam këtë prioritet. Pasi që sporti bienë në këtë drejtori është mirë me na treguar.

**Akif Shkreta thekson:-** ministria e arsimit në bashkëpunim me rektoratin e universitetit të Prishtinës janë duke e hartuar një program që departamentet të cilat janë të mjaftueshme në nivel të shtetit të myllen dhe në mungesë të kuadrit të hapen degë të reja. Është mirë që drejtoria të hartoj në lloj plani që të sheh mungesën e kuadrit deficitarë të Hanit të Elezit se çka kemi mungesë.

**Teuta Shkreta thekson:-** prioritet i është dhënë mjekësisë së përgjithshme dhe stomatologjisë por propozoj që si prioritet t'i jepet edhe pediatrisë. Siç potencojoj z. Nuriman Kukan në diskutimin që patë, edhe unë mendoj që përrinin që s'është bërë fare pak por duhet që për vitin e ardhshëm të ndahen mjete financiare për këtë çështje.

**Menduh Vlashi thekson:-** propozimin që të hyjnë edhe studentët e akademisë së arteve u pajtova që me hyjë. Sa i përket platformës së drejtimeve ata duhet të vendosin se në cilat fakultete duhet të pranojnë më shumë e në cilat më pak. Kur është miratuar rregullorja jo rastësish të kam lënë numrin e studentëve që marrin bursa dhe fakultete prioritare kuvendi i komunës me i caktuar. Drejtoria bënë propozim vendimin kurse ju mund t'i hiqni apo t'i shtonit drejtimet. Për drejtimet që nuk i kemi në Han të Elezit duhet të ndajmë pavarësisht a u ofrojmë punë apo jo por duhet të stimulohen në mënyrë që të kemi profile. Kuadrin deficitarë kuvendi i komunës e përcakton, kurse si drejtori japim propozim me të cilin mendojmë që këto janë kuadra deficitare për komunën e Hanit të Elezit. Në

këtë mbledhje po bisedojmë për bursat e studentëve por në kuadër të rinisë hyjnë edhe studentët sepse mjetet financiare po ndahen për rini. Sa i përket propozimit që prioritet të jetë edhe pediatria e përkrahi dhe është mirë të jetë prioritet.

**Kryesuesi thekson:-** propozimin e z. Teuta Shkreta e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedhë në votim propozim vendimin; rezultati i votimit ishte 13 për dhe 1 kundër.

#### **U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BURSA PËR STUDENTË NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN AKADEMIK 2018/2019**

#### **3. Miratimi i planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2019.**

**Kryesuesi thekson:-** në mbledhje të KPF-së kemi dhënë disa rekomandime në planin punës së komitetit për komunitete për vitin 2019 dhe i kanë bërë përmirësimet. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** në KPF diskutuan për planet dhe u dhanë vërejtje të arsyeshme sepse këto plane vetëm po këmbehen me njëri tjeterin sa me i bërë formale. Mirë do të ishte që në bazë të propozimeve që u potencuan nga KPF-ja të miratohen në kuvend dhe pastaj të zbatohen në organet përgjegjëse që secili e ka përgjegjësinë.

**Mefail Suma thekson:-** unë kam parashtruar pyetje se a ekziston rregullorja për komitetin për politik e financa, më jeni përgjigjur që ekziston por nuk jam i bindur që është. Në atë rregullore shënon që çdo tre muaj komiteti për politik e financa është i obliguar që t'i raportoj kuvendit se sa mjete financiare ka komuna dhe nuk e ka bërë. Nuk keni rregullore të punës as për komitetin për komunitete dhe nëse nuk keni rregullore të gjitha kompetencat i keni përzier dhe është mirë që të bashkëpunoni me komunat e tjera dhe ndani kompetencat e secilit komitet dhe nëse i keni rregulloren na i dërgoni sepse duhet të dihet që secili komitet çfarë kompetenca ka.

**Kryesuesi thekson:-** komiteti për komunitete është komitet obligativ dhe bazohet në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe në udhëzimin administrativ që është për komitete obligative dhe ekziston rregullorja për komitete obligative dhe komitete konsultative. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i ishte 13 për, 1 kundër.

#### **U MIR PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2019**

#### **4. Miratimi i planit të punës së tri komitetet konsultative për vitin 2019.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma thekson:-** komiteti për zhvillim ekonomik planifikim urban dhe mbrojtje të ambientit është përgjegjës për përkrahjen e programeve për zhvillim ekonomik të komunës duke përfshirë organizimin e panaireve në tregje. Inkurajimin e bizneseve dhe zhvillimin e turizmit, bashkëpunimin me bizneset lokale apo të përfaqësuara në nivel lokal. Inicimin e programeve dhe projektet zhvillimore ekonomike për zonat urbane dhe rurale. Shqyrtimin dhe propozimin e masave për sigurimin e mbrojtjes së pyjeve. Shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin e bujqësisë. Shqyrtimin dhe propozimin e masave për zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturës në zonat industriale dhe në zonat e veçanta rurale. Mbështetjen e rindërtimit të pjesëve të qytetit, të fshatrave dhe shqyrtimin e programeve për zhvillim ekonomik. Të gjitha këto që i përmenda janë në kompetencë të këtij komiteti.

**Akif Shkreta thekson:-** në komitet për politik e financa i kemi diskutuar në detale secilën pik veç e veç dhe kemi dhënë rekomandimet të cilat kanë qenë në pikë të shkurtra që materiali është shumë i ngarkuar dhe përfundimisht jemi dakorduar që anëtarët e komitetet e ta ndjekin trajnimin siç e ka organizuat OSB-ja. Gjatë trajnimit të ju shpjegohet të gjitha gjërat në mënyrë që t'i kuptojnë detyrat e tyre për cilat pozita janë.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** në KPF i kemi diskutuar planet e komiteteve por është mirë që përgjegjësitë të ndahen për secilin komitet dhe tu epen detyrat dhe pastaj në raporte shihet se sa është punuar.

**Mefail Suma thekson:-** kërkoj që të na dërgohet rregullorja për punën e komiteteve konsultative dhe rregulloren e këshillave të fshatrave.

**Kryesuesi thekson:-** pas mbledhjes së komitetit për politik e financa takim kam pas me kryesuesit e komiteteve dhe plani ka ndryshime sepse i kanë marr parasysh rekomandimet tona. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i ishte 13 për, 1 kundër.

#### **U MIRATUA PLANI I PUNËS SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2019**

**5. Miratimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2019.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma thekson:-** plani është shqyrtuar në këshillin komunal për siguri në bashkësi dhe temat janë gati se të njëjtë sepse kanë të bëjnë me siguri në bashkësi. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma thekson:-** në fshatin Dimcë janë dy shtylla të rrymës elektrike të tensionit të lartë të cilat vetëm telat janë duke i mbajtur dhe paraqesin rrezik. Nuk di administratori i fshatit a i ka përcjellë por është mirë të rregullohen.

**Akif Shkreta thekson:-** në plan të punës duhet të parashihet edhe ndotja e ambientit në komunën tonë. A është diskutuar ndërprerja e energjisë elektrike në pjesën nën hekurudhë dhe nëpër fshatrat që janë në atë pjesë, për shkak se është shqetësim i atyre fshatrave sidomos sezona e dimrit sepse një pjesë e qytetarëve kanë nxehje qendrore që u shkakton probleme ndërprerja e energjisë elektrike.

**Florim Shkreta thekson:-** a do të merret seriozisht trajtimi i qenve endacak. A do të merret seriozisht çështja e vendosjes së shenjave në komunikacion. Sensibilizimi për parandalimin e narkotikëve, vendosja e mbrojtësve nëpër trotuare. Eliminimin e deponive ilegale. Çështja e bashkëpunimit me KEDS-in besoj që mund të bëhet shpejtë, mirëpo pasojet janë prej komunës sepse nuk kanë kontribuar në këtë drejtim. Është paraprë të diskutohet siguria nëpër shkolla dhe kërkojë sqarim për këtë pikë.

**Nora Xhoni thekson:-** sensibilizimi për parandalimin e narkotikëve dhe duhanit por do të ishte mirë që të diskutohet edhe për pijet energjike për me u ndaluar.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** është paraprë sensibilizimi për parandalimin e narkotikëve dhe duhanit, por ndoshta do të ishte më mirë të jetë parandalimi i përdorimit dhe shitjes së narkotikëve. Nëse ju kujtohet kam kërkuar se çka është planifikuar dhe çka është punuar në mënyrë që gjatë raportit të shohim se a janë identifikuar këto probleme dhe janë kryer këto punë. Është paraprë shtimi i kamerave në zonat rurale dhe ne dimë që ka kamera gjithçka por vjedhjet kanë ndodhë e zbulimet nuk janë bërë dhe nuk është marr ndonjë masë e veçantë. Pajtohem me z.Akif Shkreta që të diskutohet për pastrimin e mjedisit por pavarësisht që pastrohet mjedisit duhet të diskutojmë për menaxhimin e mjedisit.

**Isni Bushi thekson:-** drejtorët e shkollave kanë bërë kërkesë për me bërë patrullime policia për rreth shkollave sepse te shkolla e mesme shkojnë persona të rinjë me vetura dhe e bllokojnë parkingun dhe hyjnë në oborr të shkollës dhe paraqesin pengesa.

**Rufki Suma thekson:-** nëse janë dëmtuar shenjat diku duhet të zëvendësohen me shenja të reja. Gjatë vitit që shkojë kemi pas dëmtim të shenjave për shkak të punimeve të kompanisë “Bektelenka” dhe kemi kërkuar nga kompania që t’i riparon shenjat të cilat i ka dëmtuar. Nëse nuk i riparon kompania atëherë Ministria e Infrastrukturës e ka për obligim me i rregulluar. Trajtimi i qenve endacak është shumë problem dhe është biseduar në nivel të Kosovës dhe janë marr vendime që me u bërë trajtimi në tërë Kosovën por nuk është bërë sepse ka komuna që kanë shpenzuar mjete financiare në shumë prej 50000 € dhe përsëri qentë janë marr nga një komunë dhe janë dërguar në komunën tjeter. Në ato fshatra që ka problem me rrymë duhet që kryetari i këshillit të fshati të paraqesë kërkësë në KEDS, mirëpo komunë për hir të komunikimit që mundet me shpejtuar çdo herë kërkësat që janë parashtruar në komunë të cilat kanë pas të bëjnë me rrymë, me shkresë ju kemi drejtuar KEDS-it në mënyrë që me u kryer më shpejtë. Ndërprerjet të cilat ndodhin nën hekurudhë janë defekte sepse ju e dini që në Han të Elezit asnë herë rryma nuk është ndal me reduktimet për dallim prej komunave të tjera që ka reduktimet të rregullta. Kërkësë kemi bërë që me i ndarë krejt fshatrat sepse nëse ka defekt në Krivenik fshatrat tjerë me pas rrymë, mirëpo premtimet ka por me shkrim nuk kemi. Është mirë që gjatë bisedave me ju rekomanduar fëmijëve që mos me konsumuar pije energjike. Policia bënë patrullime jashtë oborrit të shkollës për shkak se të ritë shkojnë me vetura dhe mund ta pengojnë procesin mësimorë kurse brenda oborrit të shkollës policia nuk hynë.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2019**

##### **6. Miratimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2019.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma thekson:-** edhe për këshillat e fshatrave duhet të jetë rregullorja sepse komunat e tjera e kanë rregulloren. Këshillat e fshatrave në plan e kanë paraparë miratimin e raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2018 dhe nuk është dashur me planifikuar këtë pikë për shkak se nuk është kompetencë e tyre. Kompetencat e këshillave të fshatrave nuk figurojnë në këtë plan dhe kërkojë që këshillat e fshatrave të punojnë në bazë të rregullores. Kanë planifikuar takim çdo tre muaj me fshatarë dhe është mirë të jetë çdo dy muaj takimi me fshatarë.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i ishte 13 për, 1 kundër.

#### **U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2019**

##### **7. Informatë mbi veprimtarit afariste.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Laçi thekson:-** gjatë viti 2018 në komunën e Hanit të Elezit kanë qen 275 biznese aktive dhe nga ky numër 37 biznese janë biznese të reja të regjistruara në vitin 2018. Nga ky numër 29 biznese janë me pronare femra. Faturimi për vitin 2018 është në shumë prej 88,457.80 €. Inkasimi për vitin 2018 është në shumë prej 74, 475.60 €. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabedin Hasallari thekson:-** është dashur të specifikohen edhe informacionet për vitin 2017 për bizneset në mënyrë që të kemi mundësin me bërë një kahasim vitin 2017 me vitin 2018. Për vitin 2017 nuk janë potencuar se sa biznese janë të mbyllura kurse në vitin 2018 janë vetëm 7 biznese të mbyllura që është një sukses në kahasim me regjistrimin. Është dashur të jetë inkasimi për vitin 2017 në mënyrë që të dihet se cila periudhë ka qenë më e suksesshme.

**Sevime Laçi thekson:-** për çdo vit paraqesim këtë informatë dhe në tabelë janë shënuar se sa biznese janë aktive. Në KPF më është parashtruar një pyetje në tërësi për borxhet e bizneseve ndaj komunës. Borxhi total është në shumë 258 953.39 € duke përfshirë tri biznese të cilat e rrisin këtë numër, e që dy prej të cilave jemi në proces gjyqisorë, kurse njëri është duke bërë pagesën me këste. Borxhet e tjera janë që janë bartur prej komunës së Kaçanikut.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

#### **8. Miratimi i kërkesës për përcaktimin, emërtimin e sheshit dhe ngritjen e një shtatore për dëshmorin Gafurr Loku.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** kam shfrytëzuar të drejtën me propozuar një pikë të rendit të punës që të diskutohet në kuvendin e komunës për emërtimin e një sheshi në Han të Elezit i cili mungon qe shumë vite. Është 20 vjetori i vrasjes së dëshmorit “Gafurr Loku” dhe kam konsideruar që është tepër e nevojshme, e domosdoshme për ta pasur një shesh dhe një shtatore të dëshmorit “Gafurr Loku”. Këtë të drejtë e kam parashtruar në komitet për politik e financa dhe është miratuar unanimisht që të kalojë në kuvendin e komunës. Materialin keni pranuar me siguri të gjithë dhe ka qenë e pranueshme për të gjithë. Paraprakisht e diskutuam me kryetarin e komunës dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe arritëm me një konsensus të përbashkët për mos me krijuar amulli dhe një lloj çregullimi, keqkuptimi, keq interpretimi në opinion, për shkak se kjo pikë u cilësua pak më e ndishme me që nuk duhet të cilësohej në këtë mënyrë por me gjithë atë u pajtova plotësisht me që e kisha paraprakisht një ofertë të tillë në këtë rast me familjen e dëshmorit “Gafurr Loku”, me organizatat e dalura nga lufta nga të cilat kam edhe konfirmimin për këtë pëlqim, përvëç familjeve të dëshmorëve që fatkeqësisht nuk ka shoqatë në Han të Elezit. Pranova që kjo kërkesë që është parashtruar në emrin tim si anëtarë i komitetit për politik e financa në grupin parlamentare të Partisë Demokratike për të mos u keq interpretuar kjo, me vetëdije të plotë, me përgjegjësi të plotë ja kalojë në pronësi këtë kërkesë si sponsorizues i kërkesës të jenë kategoritë e dalura nga lufta e jo emri imë në mënyrë që mos të krijohet ndonjë keq interpretim apo diçka që i çregullon qytetarët e Hanit të Elezit, familjet e dëshmorëve, kategoritë e tjera të dalura nga lufta. Gjatë bisedës kryetari e shpjegojë por isha në dijeni për projektin për pllakat që do të vendosen aty ku kanë rënë dëshmorët që jam pajtuar me këtë projekt, mirëpo ideja ka qenë që sheshi të emërohet me emrin e “Gafurr Loku” dhe shtatoren e “Gafurr Loku”. Pastaj ato profesionale bie te ata nëse krijohet komision i cili do të merret me anën profesionale dhe paraqitjen e projektit për atë shesh. Kërkoi që të jemi shumë të kujdeshshëm sepse është 20 vjetorë dhe vit jubilar, nëse shkon në pafundësi që do të bëhet ndonjë herë nuk pajtohem nëse shkon kështu, por kjo të merret shumë seriozisht në mënyrë që të krijohen grupet punuese e me shumë seriozitet të punohet në këtë drejtim.

**Rufki Suma thekson:-** paraprakisht biseduam se kur ka të bëjë me kategoritë e dalura nga lufta të kemi një pajtim të plotë që asnjë herë mos dalim në atë kuptimin me vota sepse gjithmonë dikush propozon por të jemi unik siç kemi qenë deri tash. Vitin e kaluar kur është bërë projekti për dëshmorët është bërë për rregullimin i pllakave përkujtimore për dëshmorët dhe e di që deri tash ka pas të meta sepse nuk e kemi bërë. Pvarësishtë se ndoshta ka mundur me u rregulluar në forma individuale por i kemi mundësitet materiale që si komunë me rregulluar. Si ekzekutiv kemi planifikuar që pasi që është njëzetë vjetroi, me vendosë pllakë përkujtimore në vendet e rënies së dëshmorëve dhe me u bërë një pllakë për viktimat civile sepse gjithmonë i kemi lënë anash. Krahas pllakave në vendet e rënies të bëhet një pllakë para komunës që do t'i ketë emrat e të gjithë dëshmorëve dhe emrat e viktimate civile të kohës së fundit. Gjithmonë në planet e tona ke qenë që të eliminohet objekti i shtëpisë së vëtmuarve dhe posta në mënyrë që të krijohet një shesh dhe e madhështon busti i dëshmorit atë shesh për shkak se hapësira është më e madhe. Për këtë çështje duhet të krijohet një komision nga kuvendi i komunës i cili do të bashkëpunon me shoqatat e dalura nga lufta dhe besoj që nuk do të ketë ndonjë problem. Ne u dakorduam sot gjatë bisedës që patëm me grupet parlamentare që kjo çështje t'i mbetet shoqatave të dalura nga lufta por jo në pafundësi.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ashtu siç u dakorduam në takim dhe ai dakordim u përcjell këtu dhe më vjen mirë që kemi arritur një mirëkuptim që ky shesh duhet të jetë por jo të vonohet në pafundësi. Të merret me seriozitet më të madh kjo çështje sepse mund të zhagitet me vitet të tëra.

**Mefail Suma** thekson:- propozimin që e parashtroj shefi i grupit parlamentarë të PDK-së më pëlqeu dhe ndoshta është e vonuar paka por ma mirë vonë se hiq. Nëse nuk e prishë përmbajtjen e propozimit mendoj që të jetë sheshi i dëshmorëve në shumës e jo në njëjës, për shkak se dëshmorë kemi shumë dhe me i kombinuar krejt dhe shtatorja e cila do të vendoset me ra pak ma në sy dëshmori “Gafurr Loku”.

**Kryesuesi** thekson:- shefat e grupeve parlamentare u pajtuan që procedurat me u shpejtuar, kurse për emërtim besoj që do të jetë një komision i cili do ta merr përsipër çështjen e emrit, çështjen e sheshit dhe gjitha procedurat.

**Nuriman Kuka** thekson:- në emër të grupit parlamentarë e përkrahim propozimin e z.Mehmet Ballazhi për procedura të më tutjeshme dhe atë që e potencojoj z. Mefail Suma besoj që komisionet gjatë takimeve që do t'i mbajnë do të dakordohen. Më vjen mirë që u arrit një ujdi e mirë që të vazhdohet më tutje kjo çështje.

**Nora Xhoni** thekson:- në emër të grupit parlamentarë të aleancës për ardhmërinë e Kosovës e përshëndesim këtë ide por pasi që objektivat e kryetarit të komunës po përputhen me idenë e kësaj marrëveshje, si grup parlamentarë këtë çështje ja besojmë kategorive të daluara nga lufta dhe për një kohë të shkurtë besoj që do të bëhet kjo.

**Akif Shkreta** thekson:- duhet të jemi falënderues të gjithë për çështjen që e ka ngritur përfaqësuesi i PDK-së i cili e ka adresuar këtë çështje dhe të shpien në një çështje tjeter që është e ndërlidhur me planin e punës së kryetarit të komunës me 20 vjetorin. Si lëvizje vetëvendosje i mbështesim këto nismat që vijnë nga kategoritë e dalura nga lufta që kanë të bëjnë ekskluzivisht për dëshmorët, andaj mendoj që në komunën tonë duhet të krijohet një grup punues i cili jep kontribut në çështje të tillë dhe jo me krijuar një far lloj konfuziteti, por me krijuar një grup punues i cili do ta bënë një far plani për këtë çështje. Do të ishte mirë që projekti me u bërë në formë të dëgjimit publik sepse është për dëshmorët për ata të cilët kanë sakrifikuar që ne sot jemi të lirë dhe fryshtësirë lirshëm dhe nuk duhet të kursejmë asgjë apo ty japim anime apo kahje të ndryshme. Edhe një herë e përgëzojë parashtruesin e kërkësës i cili në bashkë koordinim me të gjithë ne e zhvendosim këtë pikë te kategoritë e dalura nga lufta.

**Kryesuesi** thekson:-nga të gjitha diskutime që u dhanë deri më tanë do të thotë dakordohemi që kjo çështje të procedohet më tutje në bazë të dakordimeve që janë arritur në mes shefave të grupeve parlamentare dhe kryetarit të komunës. Pasi që nuk ka diskutime të tjera e hedhë në votim rezultati i votimi ishte njëzëri.

## 9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:- kuvendi i komunës ka bërë padi për dëmet e luftës që janë shkaktuar këtu në Han të Elezit dhe deri ku ka mbërri padia që është bërë ndaj Serbisë. Po flitet se ferovija e ka denonuar komunën tonë se gjoja se e ka rrënuar një objekt të ferovisë dhe a është e vërtetë. Me që komuna nuk na ka dhënë zyre për partinë politike nisma dhe lëvizjen vetëvendosje atëherë ne të na i paguan qiratë për zyre.

**Florim Shkreta** thekson:- duhet të trajtohen këshilltarët njëjtë në përgjigjet e tyre që epen. Në përgjigjet e z.Mefail Suma është shënuar i nderuar zotëri këshilltarë, kurse te përgjigjet e mia nuk shënoni asgjë. Kam kërkuar një përgjigje dhe kam aluduar në emrin z.Sami Brava por kam përmendur emër tjetër, mirëpo në fakt unë mendova si kryesues e kuptove se për çka bëhet fjalë sepse diskutove për atë çështje por ndoshta ke harruar dhe nuk është mirë me u bërë jo vetvetja. Përgjigje me shkrim kërkoi se sa është paguar dëmi i objektit në oborrin e komunës që është bombarduar që është pronë e z.Sami Brava. Sa është paguar kompletë ajo parcelë. Si janë zhvilluar procedurat e parcelës në fjalë.

**Kryesuesi thekson:-** përgjigjen ta ka dhënë ekzekutivi i komunës dhe është mirë të jeni më principiel në mënyrë që ata të cilët t'i jadin emrat ne të jenë pak më të saktë.

**Florim Shkreta thekson:-** unë jam i votuar nga qytetarët dhe kam drejtë me secilin me nejtë po nuk jam i kapt ashtu siç je ty por unë jam vjetvetja. Unë bisedoj me çdo këndë dhe është tmerr me u përzirë kryetari i komunës dhe pushtetit se me kënd me nejtë dhe me kënd mos me nejtë.

**Besarata Suma thekson:-** kam disa kërkesa të qytetarëve në shëndetësi sepse kur është në pyetje jeta e tyre në ambulantë disa shërbime nuk kryhen për shkak se disa aparatura janë jashtë funksionit. Aspiratorin e frysëmarrjes e kam cekur edhe më herët dhe dua të dijë se çka është bërë në këtë drejtim. Defribulatori është lloj elektroskopij automatik që i ndihmon personat të cilët kanë atak kardiak, ekziston por është jashtë funksionit. Ky funksionit. Adrenalina lëshohet në trupin e njeriut kur ka stres psikik ose bllokadë në tru dhe dinë me përdorë vetëm mjekët dhe infermieret nuk kanë njohuri për këtë por duhet me u trajnuar. Monitori për leximin e të dhënavë të zemrës, frysëmarrjes, pulsit ekziston por është jashtë funksionit. Nëse nuk keni përgjigje për momentin kërkoi me shkrim që të më përgjigjeni.

**Akif Shkreta thekson:-** a ka mundësi financiare ekzekutivi i komunës që ta bënë një gazetë një mujore apo dy mujore për të arriturat e komunës sonë sepse nuk ka një kosto të madhe dhe mund të bëhet për shkak se një kategori e personave nuk kanë qasje në media. Objektet nëntokësore që janë te ish pronat e sekretariatit të mbrojtjes çka planifikon komuna që të bënë me ato objekte sepse janë në gjendje jo të mirë por mund të ketë rrezik të përgjithshëm.

**Florim Shkreta thekson:-** me që jemi te pika e rendit të punës të ndryshme, dua të lidhem me disa intervista të kryetarit apartiak. Dy fjalë për Haredinajn dhe Hashim Thaçin pa dyshim se është kryetari më i veçantë në të gjitha komunat e Kosovës pse jo edhe më gjëra, ishalla je mua më pëlqen. Ka filluar mandatin e tretë pa bërë asnjë fushatë elektorale dhe pa qenë pjesë e ndonjë partie politike për më tepër ndër Qeveritë më të pastra, pa asnjë njollë aboziviteti që do të thotë që fjala është për kryetari z.Rufki Suma i cili nuk premton por vetëm realizon. Po më intereson ta dijë i nderuar kryetarë e ka zënë veten ndonjë herë duke gënjer. Është e vërtetë që e ke fituar mandatin e tretë por fushatë elektorale ke bërë dhe nuk e di a je në dioni sa e ke paguar faturën te z. Sadat Curri dhe fushatë është kur i tubon qytetarët nëpër fshatra. Thuhet ndër qeveritë më të pastra por i mbetet kohës. Thuhet pa asnjë parti politike por dihet që është qeverisë prej tri partive politike, partinë e katërt nuk munde me arritur se kryetari i nismës t'i shkarkojë tre anëtarët prej kryesisë aty. Një pjesë e qytetarëve i dinë fjalë e tua. Potencon dy fjalë për Haredinajn dhe Hashim Thaçin për korrigjin e kufijve me Serbinë por ne dimë që je kryetarë i përmasave të mëdha dhe ke pas rast me treguar veten sepse shteti Maqedon ku do ka prekë në territor dhe nuk keni ndërmarr asgjë për këtë çështje. Unë nuk mendoj që je bash kështu siç potencon sepse për pro Serbin Grekun i ke fal tokë pa pëlqimin e banorëve të fshatit Seçishtë.

**Hanumshahe Dibrani thekson:-** vërejtje kemi nga qytetarët për rrugën "Ismail Qemali" që nuk është rregulluar ashtu siç duhet. Në këtë rrugë shtyllat e rrymës elektrike të cilat janë me dru të zëvendësohen me shtylla të betonit për shkak se çdo herë kur fryen era ndërpritet rryma elektrike. Për këto probleme është mirë që komuna ta njofton KEDS-in.

**Samire Curri thekson:-** kur do të përfundojnë punimet për objektin e çerdhes për fëmijë. Sa punëtorë planifikohen të punësohen aty.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** banorët e lagjes nën hekurudhë a janë me ujësjellësin e rekës apo me ujësjellësin e Glloboçicës. Nëse jemi të kyçur me ujësjellësin e rekës e kuqtojë pse është i turbullt dhe nëse jemi të këqyr me ujësjellësin e Glloboçicës pse është i turbullt.

**Rufki Suma thekson:-** padia kundër Serbisë është dërguar prokurorisë speciale të Kosovës dhe prokuroria speciale e Kosovës ja ka dërguar Euleksit. Vetëm një herë na është kthyer një përgjigje se kur ja kanë përcjelle potencuar që na është dhënë lënda por vetëm për një segment për rastet e dhunës seksuale të cilët kanë kërkuar se a mund të na ndihmoni për ata dëshmitarë dhe asnjë informatë tjetër nuk kemi. Për objektin e ferovisë kemi pas kërkesë në KKSB dhe banorët që të rrënohet objekti për shkak se objekti u shëndrrua për mbeturina dhe për qëllime të tjera. Në momentin që komuna e ka rrënuar objektin hekurudha na ka dërguar vërejtje dhe ka kërkuar që ta rikthen objektin e rrënuar. Komuna është përgjigjur me shkrim që si pasojë e mos menaxhimit të mirë objekti është shfrytëzuar për gjithçka. Sa i përket zyrave për partitë politike nuk ka zyre dhe zyret të cilat janë ua kemi dhënë partive politike që janë pjesë e kuvendit të komunës dhe po të kemi zyre do tu takon edhe vetë vendosjes edhe nismës. Ju të gjithë e dini problemin e pronave që i kemi për rrëth komunës të cilat janë prona private. Për njëren pronë janë zhvilluar procedurat kurse për tjetër nuk kemi ende. Sa i përket intervistave ata janë komente të gazetarëve dhe ata munden me na shahë dhe munden me na lëvduar por është çështje e gazetës. Pajisjet të cilat janë në ambulantë dhe kanë ndonjë defekt kemi potencuar se do të riparohen sepse kemi pas raste edhe me aparatin e ekagesë sepse nëse nuk riparohet dhe testohet nuk t'i jep të dhënët e sakta. Po të kemi mundësi financiare do të ishte mirë që për çdo muaj me pas gazetë ditore, mirëpo përmes internetit mund të njoftohemë për gjithçka. Përveç internetit e kemi edhe vjetarin e komunës që në fund të vitit dalin të gjitha aktivitete. Objektet e ish armatës janë dhënë me vendim të kryeministrat që i epen komunave në menaxhim dhe presidenti ju ka drejtuar gjykatës kushtetues se a janë në përputhje me kushtetutshmërinë dhënia e atyre pronave. Nga ministria na është dërguar që mos me vepruar diçka në ato prona por komuna e ka ndërtuar çerdhen e fëmijëve në të cilën kanë përfunduar gjitha punimet dhe janë pajisur me gjitha elementet e domosdoshme, mirëpo vetëm pritet vendimi nga Ministria por kjo varet nga miratimi i buxhetit të Kosovës. Te objektet e ish armatës me plan zhvillimore përcaktohet se për çka do të shfrytëzohen. Ku do që ka shtylla elektrike të drurit kemi kërkuar prej KEDS-it që me i zhvendosë sepse shumica e shtyllave janë nëpër livadhe apo ara, mirëpo kemi kërkuar që të gjitha me i vendosë për rrëth rrugës dhe me u shfrytëzuar për ndriçim. Lagja nën hekurudhë furnizohet me ujë të Glloboçicës që është në menaxhimin e kompanisë "Bifurkacion".

**Refet Kalisi thekson:-** uji i turbullt vjen ndonjë herë për shkak të shtypjes sepse kur ndërprenet në rezervarë gypat nuk ja të pastruar ashtu siç duhet dhe sipas mendimit tim është ky problem.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** nëse potencoher se uji është i pishëm dhe ai moment mund të jetë i shkurtë ose i gjatë por infeksione mund të ketë por duhet të vërtetohet se ka vjen dhe me u eliminuar problemi.

**Florim Shkreta thekson:-** nga drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale kam kërkuar një listë të evidencave dhe nuk e ka dërguar. A keni pasur ndonjë mësimdhënës që është dashur t'i shpallet vendi i lirë i punës dhe ju nuk keni shpall konkurs. Sa i përket ujtit nuk e dijë a janë në dioni komuna se fshati Dërmjak e derdhë kanalizimin në rek.

**Menduh Vlashi thekson:-** nga viti i kaluar deri tash i bëjë një vit që e kam marr mandati dhe ashtu siç i kam gjet mësimdhënësit dhe vetëm për ata të cilët e kanë lëshuar vendin e punës dhe ata të cilët kanë vdekur e kam shpall vendin e lirë të punës. Shumica e arsimtarëve kanë mbi dhjetë vite punë dhe është problem me ua shpallur vendin e lirë të punës sepse kemi probleme me inspektorët e punës.

**Florim Shkreta thekson:-** kërkoj informacione me shkrim listën e të gjithë mësimdhënësve fillorë dhe të mesëm, përgatitjet profesionale dhe çfarë drejtimi ushtrojnë.

**Hanumshahe Dibrani thekson:-** propozimet të cilat i kam dhënë në vitin 2018 asnë nuk është realizuar.

**Medina Imishti thekson:-** sa i përket listës së evidencave i kam të printuara në zyre dhe mundesh me ardhur mi marr ata të cilat prej kur ka filluar unë në këtë drejtori.


**Menduh Vlashi thekson:-** si anëtarë të kuvendit të komunës mund të kërkoni informacione me shkrim por ne mund të përgjigjemi sipas legjislacionit në fuqi.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Procesmbajtësi

Avni Bushi





Kryesuesi i Kuvendit  
MSc. Qamush Brava